Shtojca 1

Formulari i kërkesës për leje mjedisore



Emri i Kompanisë	**"Toni Compani" SH.P.K.**
Lloji i Veprimtarisë	**Eksploatim i gëlqeroreve** **(Zgjerim i vendburimit)**
Vendi/Lokacioni ku zhvillon veprimtarinë	**Reçak, komuna e Shtimes**
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	**Faton Nuredini**
Adresa	**Rr. Joe Beau Biden, nr.950, Ferizaj**
Telefoni, fax, e-mail	**+38349400082, info@tonibeton.com**
Emri dhe Mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për Mjedis	**Fisnik Musa** **Nr.tel. +383 49 943 366**
Adresa	**Rr. Joe Beau Biden, nr.950, Ferizaj**
Përshkrimi i dokumentacionit të bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	- **Certifikata e regjistrimit te Biznesit me nr. Unik Identifikues: 810649915, 24/04/2002** - **Formulari i plotësuar sipas kushteve ne shtojcën 2,** - **Leje Mjedisore: 6678-2/19, 28.08.2020** - **Pëlqimi Mjedisor: 7615-2/18, 03.04.2019** - **Pëlqimi Mjedisor për zgjerim: 4406-2/23, 18.03.2024** - **Licenca KPMM-së: 2466/KPMM/2026** -
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit(euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë	- **Kosto investive: 97,500 €**
Fatura e pagesës së tarifës për Leje Mjedisore	**PO**
Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në Një (1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD)	**PO**

Shtojca 2


Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore


APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	"Toni Compani" SH.P.K. Eksploatim i gëlqeroreve (Zgjerim i vendburimit)
	Vendi	Reçak, Shtime
	Adresa	Rr. Joe Beau Biden, nr.950, Ferizaj
	Nr. i tel./fax	+38349400082
	E-mail	info@tonibeton.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810649915, 24/04/2002
1.1.3.	Personi Përgjegjës i kompanisë	Faton Nuredini
	Nr. i tel./fax	+38349400082
	E-mail	info@tonibeton.com
1.2. Të dhënat për kompaninë		
1.2.1.	Emri i kompanisë	"Toni Compani" SH.P.K. Eksploatim i gëlqeroreve (Zgjerim i vendburimit)
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Reçak, Shtime

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Lokacioni ku kompania "Toni Compani" SH.P.K. zhvillon veprimtarinë e eksploatimit të gëlqerorëve dhe zgjerimin e vendburimit ekzistues ndodhet në zonën kadastrale Reçak, Komuna e Shtimes përkatësisht në ngastrat kadastrale nr. P-72809071-00070-0 dhe P-72809071-00075-0. Kompania posedon dy Pëlqime Mjedisore për zhvillimin e kësaj veprimtarie, përkatësisht **Pëlqimin Mjedisor** me nr. protokolli 7615-2/18, të datës 03.04.2019, për eksploatimin e gëlqerorëve, si dhe **Pëlqimin Mjedisor për zgjerimin e vendburimit** me nr. protokolli 4406-2/23, të datës 18.03.2024 dhe gjithashtu lejen mjedisore të skaduar me sipërfaqe 4ha. Veprimtaria përfshin sipërfaqen ekzistuese të eksploatimit dhe sipërfaqen e zgjerimit të vendburimit, të cilat trajtohen si një tërësi funksionale. Zona e eksploatimit ndodhet rreth 5 km nga qyteti i Shtimes.  

2.2.	Numri kadastral i parcelës	Lokacioni i eksploatimit të gëlqeroreve ndodhet në zonën kadastrale Reçak, Komuna e Shtimes përkatësisht në ngastrat kadastrale nr. P-72809071-00070-0 dhe P-72809071-00075-0. 
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Lokacioni i eksploatimit të gëlqerorëve të kompanisë "Toni Compani" SH.P.K. ndodhet në zonën kadastrale Reçak, Komuna e Shtimes. Distanca nga objektet e banimit në drejtim të fshatit Reçak është rreth 1.06 km. Në zonën përreth ndodhen edhe objekte dhe aktivitete të tjera, si Rinori Garden (1.60 km), Kopshti Arti SH.P.K. (1.29 km), FSH Computers (1.42 km), Stacioni i Policisë së Kosovës (1.32 km), Lapidari i Dëshmorit "Shaqir Berisha" (1.42 km) dhe Shtabi i UÇK-së në Rancë (975.19 m). Gjithashtu, në afërsi të lokacionit gjenden rrugë të qasjes, sipërfaqe pyjore dhe aktivitete të tjera ekonomike. 

		
2.4.	Të dhënat lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Flora në Komunën e Shtimes karakterizohet nga vegjetacioni pyjor, shkurret dhe bimësia barishtore. Në zonat kodrinore dhe malore dominojnë pyjet e dushkut dhe ahut, si dhe lloje të ndryshme të bimëve natyrore. Fauna e rajonit përfshin gjitarë si dhelpra, lepuri i egër, ketri dhe iriqi, ndërsa nga shpendët mund të hasen pëllumbi i egër, korbi, sorra dhe qukapiku. Lokacioni ku kompania "Toni Compani" SH.P.K. zhvillon eksploatimin e gëlqerorëve dhe zgjerimin e vendburimit është i rrethuar kryesisht nga sipërfaqe pyjore. Për shkak të aktiviteteve minerare, zhurmës dhe dridhjeve, prania e faunës në zonën e eksploatimit mund të jetë më e kufizuar. Pas përfundimit të veprimtarisë parashihet rehabilitimi dhe rikultivimi i sipërfaqeve të shfrytëzuara.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura	Në afërsi të lokacionit ku kompania "Toni Compani" SH.P.K. zhvillon veprimtarinë e eksploatimit të gëlqerorëve dhe zgjerimin e vendburimit, në Z.K. Reçak, Komuna e Shtimes, nuk janë identifikuar zona të mbrojtura të natyrës.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË		
33.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore		
3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	Gjatë eksploatimit nuk kemi proces teknologjik, kemi vetëm proces të punës. Hapat e procesit të punës jane: 1. Minimi, 2. Mbushja ne kamion me ekskavator dhe 3. Dërgimi i gurit gëlqeror deri tek vendi për thërrmim Skema e procesit të punës: Për kompaninë "Toni Compani" SH.P.K. Reçak, Komuna Shtime 
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Eksploatimi i gurit gëlqeror përfshin një seri operacionesh të specializuara për nxjerrjen e këtij minerali nga guroret.  Figura 1: Pamje e hyrjes dhe zonës së eksploatimit dhe rrethoja Më poshtë janë pajisjet kryesore dhe fazat e punës të përfshira vetëm në procesin e eksploatimit. Përshkrimi i paisjeve te cilat përdorë kompania "Toni Compani" SH.P.K.:

		1. **Buldozerë** – Përdoren për pastrimin e sipërfaqes nga dheu dhe bimësia. 2. **Makina shpimi** – Bëjnë vrima të thella në gur për vendosjen e eksplozivëve. 3. **Eksplozivë industrialë** – Përdoren për të thyer masën shkëmbore në blloqe më të vogla. 4. **Ekskavatorë hidraulikë** – Përdoren për të larguar gurin e liruar pas shpërthimit. 5. **Ngarkuesit** – Përdoren për të ngarkuar gurin në kamionë ose mjete të tjera transporti. 6. **Kamionë** – Përdoren për transportimin e gurëve nga zona e eksploatimit.  **Faza e procesit te punës të eksploatimit:** Procesi i eksploatimit të gurit gëlqeror fillon me përgatitjen e zonës së gurores, e cila përfshin pastrimin e sipërfaqes nga dheu dhe bimësia, si dhe hapjen e rrugëve të brendshme për transport. Më pas, kryhen shpime eksploruese për të përcaktuar cilësinë dhe strukturën e gurit, si dhe për të planifikuar vendosjen e eksplozivëve. Shpërthimet e kontrolluara përdoren për të ndarë masën shkëmbore në blloqe të menaxhueshme, të cilat pastaj nxirren nga guroret me ndihmën e ekskavatorëve dhe ngarkuesve frontalë. Materiali i nxjerrë ngarkohet në kamionë të rëndë dhe transportohet në zonat e

		përpunimit ose depozitimit. Gjatë gjithë procesit, zbatohen masa sigurie për të mbrojtur punëtorët dhe për të minimizuar ndikimin mjedisor, përfshirë reduktimin e pluhurit dhe rehabilitimin e zonës pas përfundimit të eksploatimit.  Komponentët hyrëse për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania " Toni Compani " SH.P.K. janë: 1. Burimet natyrore si : Guri gëlqeror dhe uji. 2. Pajisjet dhe makineritë: makinat e shpimit, eksplozivet, ekskavatorët, ngarkuesit, kamionët, buldozerët, sondat gjeologjike etj. 3. Materialet ndihmese : karburantet, lubrifikantet dhe vajrat për mirëmbajtje te makinerive, pajisjet mbrojtëse personale , sistemet e monitorimit. 4. Burimet njerëzore: inxhinierë , gjeologe, operatore te makinerive, punëtorët teknike, specialist te sigurisë. Të gjithë këta komponentë janë të domosdoshëm për të siguruar një eksploatim efikas dhe të sigurt të gurit gëlqeror. Komponentët dalës për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania " Toni Compani " SH.P.K. janë: 1. Produktet kryesore: guri gëlqeror i nxjerrë. 2. Mbetjet dhe nënproduktet: blloqe shkëmbore te pavlefshme, pluhur guri, gurë te vegjël dhe material inerte, emetime gazrash nga shpërthimi, uji i ndotur, zhurma dhe vibrime.

		Këta komponentë dalës janë pjesë e drejtpërdrejtë e eksploatimit të gurit gëlqeror dhe duhet të menaxhohen për të minimizuar ndikimin në mjedis dhe për të optimizuar shfrytëzimin e materialit.
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 ore x 6 dit 48 ore ne javë orari punës prej orës 08:00 deri 16:00.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti ditor: 708 m^3 Kapaciteti javor:4250 m^3 Kapaciteti mujor: 17,000 m^3 Kapaciteti vjetor: 170,000 m^3
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse.	Lëndë e parë: • Guri Gëlqeror Lëndë ndihmëse: • Eksplozivët • Uji • Nafta dhe lubrifikantët
3.1.6.	Lista e rezervuarve edhe kapaciteti i tyre	Kompania "Toni Compani" SH.P.K., Reçak, komuna e Shtimes, nuk posedon rezervuar.
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve në Fuqi Për plotësimin e formularit për Leje Mjedisore për kompaninë "Toni Compani" SH.P.K. për eksploatimin e gëlqeroreve (zgjerimin e vendburimit) janë shfrytëzuar: **<u>Ligjet:</u>** • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025; • Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181; • Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060; i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 dhe ndryshimet e mëvonshme, për menaxhimin e mbeturinave që krijohen gjatë aktivitetit. • Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174; • Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102; • Ligji Nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri;

		• Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025; • Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233; • Ligji nr. 04/l-147 për Ujërat e Kosovës **<u>Udhëzimet Administrative:</u>** • Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr.04/2025 për Përmbajtjen, Metodologjinë dhe Përputhshmërinë e Raportit me Kërkesat Ligjore , Praktikat e Zbatueshme dhe Aspektet e Tjera Teknike Të Raportit • Udhëzim Administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave; • Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit		
3.2.1	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania "Toni Compani" SH.P.K., për veprimtarinë e eksploatimit të gurit gëlqeror dhe zgjerimin e vendburimit në Reçak, Komuna e Shtimes, zbaton masa organizative dhe teknike për menaxhimin e ndikimeve që mund të paraqiten gjatë zhvillimit të aktivitetit. Sistemi i menaxhimit mjedisor përfshin përcaktimin e përgjegjësive të stafit, kontrollin e aktiviteteve në terren, zbatimin e masave për zvogëlimin e pluhurit, zhurmës dhe vibrimeve, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e tokës dhe ujërave, si dhe rehabilitimin gradual të sipërfaqeve të shfrytëzuara. Kompania është e përkushtuar që veprimtarinë ta zhvillojë në përputhje me kërkesat ligjore mjedisore dhe kushtet e përcaktuara në dokumentacionin mjedisor përkatës. Menaxhimi mjedisor synon: ❖ respektimin e legjislacionit në fuqi; ❖ parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis; ❖ monitorimin e gjendjes së mjedisit gjatë eksploatimit; ❖ mirëmbajtjen e pajisjeve dhe zonës së punës; ❖ komunikimin me institucionet kompetente;

		❖ rehabilitimin dhe rikultivimin e sipërfaqeve pas përfundimit të eksploatimit.
3.2.2	Raportimi	Kompania ka bere respektimin e kushteve qe kane dalur nga leja mjedisore paraprake duke bere matjen e pluhurit.

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së kompanisë "Toni Compani" SH.P.K. për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe zgjerimin e vendburimit në Reçak, Komuna e Shtimes, emisionet në ajër lidhen kryesisht me procesin e minimit, ngarkimin e materialit, lëvizjen e makinerive dhe transportin e gurit gëlqeror. Burimet kryesore të emisioneve janë: ➢ **Burimi:** Faza e shpimit dhe minimit **Emisioni:** Pluhur mineral dhe sasi të kufizuara të gazrave që krijohen gjatë shpimit dhe shpërthimeve të kontrolluara. ➢ **Burimi:** Ngarkimi i masës së gurit gëlqeror **Emisioni:** Pluhur që krijohet gjatë manipulimit dhe ngarkimit të materialit të nxjerrë në kamionë. ➢ **Burimi:** Rrugët e brendshme të paasfaltuara dhe sipërfaqet operative **Emisioni:** Pluhur i ngritur nga lëvizja e kamionëve dhe makinerive në zonën e eksploatimit. ➢ **Burimi:** Kamionët transportues **Emisioni:** Gazra nga motorët me djegie të brendshme dhe pluhur gjatë transportimit të materialit. ➢ **Burimi:** Ekskavatorët, ngarkuesit dhe makineritë tjera të punës **Emisioni:** Gazra nga djegia e karburanteve dhe pluhur gjatë punës dhe manipulimit me materialin. Për zvogëlimin e këtyre emisioneve parashihet lagia e rrugëve dhe sipërfaqeve të punës sipas nevojës, mirëmbajtja e rregullt e makinerive

		dhe kontrolli i shpejtësisë së automjeteve brenda zonës së eksploatimit.
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së kompanisë "Toni Compani" SH.P.K. për eksploatimin e gurit gëlqeror, ndikimet në cilësinë e ajrit lidhen kryesisht me krijimin e pluhurit gjatë shpimit, minimit, ngarkimit dhe transportimit të materialit, si dhe me gazrat e shkarkimit nga makineritë dhe automjetet e punës. Shkalla e ndikimit në ajër varet nga intensiteti i punimeve, numri i automjeteve dhe makinerive në operim, gjendja e rrugëve të brendshme dhe kushtet meteorologjike, veçanërisht era dhe periudhat e thata. Këto ndikime janë kryesisht lokale dhe mund të zvogëlohen përmes lagies së rrugëve dhe sipërfaqeve të punës, kufizimit të shpejtësisë së automjeteve dhe mirëmbajtjes së rregullt të makinerive. Me zbatimin e masave të parapara, emisionet e pluhurit dhe gazrave mund të mbahen nën kontroll gjatë zhvillimit të veprimtarisë së eksploatimit.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve gjatë eksploatimit të gurit gëlqeror paraqiten kryesisht nga pluhuri që krijohet gjatë lëvizjes së kamionëve dhe makinerive në rrugët e brendshme të paasfaltuara, gjatë ngarkimit dhe transportimit të materialit, si dhe nga sipërfaqet e hapura të zonës së eksploatimit. Këto emisione janë të shpërndara në hapësirë dhe varen nga intensiteti i punimeve, kushtet meteorologjike dhe lagështia e sipërfaqeve. Për zvogëlimin e tyre parashihet lagia e rrugëve dhe sipërfaqeve të punës, kufizimi i shpejtësisë së automjeteve dhe mirëmbajtja e rregullt e rrugëve të brendshme.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk ka pajisje për trajtimin e gazrave shkarkuese
4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Për de-pluhurim përdoret kryesisht uji, përmes lagies dhe spërkatjes së rrugëve të brendshme, sipërfaqeve të punës dhe zonave ku krijohet pluhur gjatë ngarkimit dhe transportit.
4.6.	Monitorimi iemisioneve	Kompania e bën monitorimin e emisioneve siç kërkohet ne Leje Mjedisore.

4.7.	Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit	Kompania “Toni Compani” SH.P.K. e bën kontroll dhe matjet e emisioneve në ajër ashtu siç kërkohet
4.8.	Raportimet	Nuk bene raportimin
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për zvogëlimin e ndikimeve në ajër gjatë eksploatimit të gurit gëlqeror, kompania “Toni Compani” SH.P.K. zbaton këto masa: ➢ rrugët e brendshme dhe sipërfaqet ku bëhet lëvizja e automjeteve spërkaten me ujë për reduktimin e pluhurit; ➢ makineritë dhe automjetet kontrollohen dhe mirëmbahen rregullisht për të zvogëluar emetimin e gazrave ➢ në periudha të thata, me temperatura të larta ose erë, rritet frekuenca e spërkatjes me ujë; ➢ kufizohet shpejtësia e automjeteve brenda zonës së eksploatimit për të zvogëluar ngritjen e pluhurit; ➢ materiali transportohet në mënyrë të kontrolluar për të kufizuar shpërndarjen e pluhurit gjatë lëvizjes.
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike, kompania “Toni Compani” SH.P.K. zbaton këto masa: • mirëmbajtjen e rregullt të makinerive dhe automjeteve për zvogëlimin e konsumit të karburantit dhe emisioneve; • shmangien e punës së panevojshme të makinerive në gjendje boshe; • organizimin efikas të transportit dhe lëvizjes brenda zonës së eksploatimit; • rehabilitimin dhe rikultivimin gradual të sipërfaqeve të shfrytëzuara; • ruajtjen, sa është e mundur, të vegjetacionit përreth zonës së eksploatimit.

5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	burim ujor. Uji sigurohet përmes cisternave dhe përdoret sipas nevojës për lagien e rrugëve të brendshme dhe sipërfaqeve të punës, veçanërisht gjatë periudhave me temperatura të larta dhe kushte të thata, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujerave sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Nuk ka shkarkim të ujërave pasi nuk ka shfrytëzim të ujërave.
5.3.	Ndikimet në ujë	Gjatë eksploatimit të gurit gëlqeror, ndikimet e mundshme në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore lidhen kryesisht me derdhjet eventuale të naftës, vajrave dhe lubrifikantëve nga makineritë dhe automjetet e punës, si dhe me bartjen e sedimenteve nga ujërat atmosferike në sipërfaqet e eksploatuara. Këto ndikime mund të parandalohen përmes mirëmbajtjes së rregullt të makinerive dhe menaxhimit të kontrolluar të derivateve.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Në kompaninë "Toni Compani" SH.P.K., gjatë veprimtarisë së eksploatimit të gurit gëlqeror nuk gjenerohen ujëra teknologjike të ndotura. Ndërrimi i vajrave dhe mirëmbajtja e makinerive nuk kryhen brenda zonës së eksploatimit, por në servise të specializuara. Për këtë arsye, gjatë operimit normal nuk parashihen emisione të ujërave të ndotura nga procesi i eksploatimit.
5.5	Trajtimi i ujërave të ndotura	Nuk është e nevojshme trajtimi i ujërave pasi nuk ka as shfrytëzim dhe as shkarkim të ujrave.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Nuk është e nevojshme
5.7.	Raportimi	Nuk bën raportim të ujerave,
5.8.	Leje Ujore për shfrytëzim të ujit	Nuk është e nevojshme pasi nuk ka shfrytëzim të ujërave
5.9.	Leje Ujore për shkarkimin e ujërave	Nuk është e nevojshme pasi nuk ka shkarkim të ujërave
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Meqenëse gjatë eksploatimit të gurit gëlqeror nuk gjenerohen ujëra teknologjike të ndotura dhe nuk bëhet shkarkim i tyre, masat kryesore

		lidhen me parandalimin e ndotjeve aksidentale. Mbeturinat komunale duhet të grumbullohen dhe të largohen në vende të përcaktuara, ndërsa ndërrimi i vajrave dhe mirëmbajtja e makinerive duhet të kryhen vetëm në servise adekuate, jo brenda zonës së eksploatimit.
6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së kompanisë "Toni Compani" SH.P.K. për eksploatimin e gurit gëlqeror në Reçak, Komuna e Shtimes, zhurma krijohet kryesisht nga makineritë dhe aktivitetet operative në vendburim. Burimet kryesore të zhurmës janë: • ekskavatorët dhe ngarkuesit; • kamionët për transportimin e materialit; • lëvizja e makinerive në rrugët e brendshme të zonës së eksploatimit. Zhurma është kryesisht e përqendruar brenda zonës së punës dhe paraqitet gjatë periudhës së zhvillimit të aktiviteteve të eksploatimit.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.
6.3.	Raportimet	Raportimi i zhurmës do të bëhet sipas kushteve që do të dalin nga leja mjedisore, do të bëhet matja dhe do të raportohet në MMPHI.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Gjatë fazës së eksploatimit të gurit gëlqeror nga kompania "Toni Compani" SH.P.K., ndikimet në tokë lidhen kryesisht me ndryshimin e relievit dhe degradimin e sipërfaqes së tokës si rezultat i hapjes dhe shfrytëzimit të etazheve të eksploatimit. Ndikime të tjera mund të paraqiten nga grumbullimi jo i duhur i mbeturinave të ngurta, prishja e peizazhit etj.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Për zvogëlimin e ndikimeve në tokë gjatë eksploatimit të gurit gëlqeror, kompania "Toni Compani" SH.P.K. zbaton këto masa: • mbeturinat e ngurta dhe komunale grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm dhe largohen përmes operatorëve përkatës; • nuk lejohet hedhja e mbeturinave në sipërfaqe të papërcaktuara; • parandalohet rrjedhja e naftës, vajrave dhe lubrifikantëve nga makineritë; • mirëmbajtja dhe ndërrimi i vajrave kryhen në servise të përshtatshme; • sipërfaqet e shfrytëzuara rehabilitohen dhe rikultivohen gradualisht pas përfundimit të eksploatimit.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Pas përfundimit të veprimtarisë së eksploatimit të gurit gëlqeror, kompania "Toni Compani" SH.P.K. do të ndërmarrë masa për rehabilitimin dhe rikultivimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga punimet minerare. Qëllimi i rehabilitimit është që zona e shfrytëzuar të përshtatet sa më shumë me gjendjen natyrore të mjedisit përreth, përmes rregullimit të terrenit, stabilizimit të sipërfaqeve, vendosjes së shtresës së dheut dhe humusit, si dhe mbjelljes së bimësisë së përshtatshme. Sipërfaqet e rehabilituara do të gjelbërohen dhe, sipas kushteve të terrenit, do të pyllëzohen me lloje bimore të përshtatshme për zonën. Kompania do të kujdeset edhe për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të rikultivuara deri në stabilizimin e tyre. Qëllimi përfundimtar është zvogëlimi i ndikimit në peizazh dhe rikthimi gradual i zonës në një gjendje sa më të përafërt me mjedisin përreth.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

<table>
<tr><td>8.1.</td><td>Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave</td><td>Gjatë veprimtarisë së eksploatimit të gurit gëlqeror nga kompania “Toni Compani” SH.P.K., gjenerimi i mbeturinave është i kufizuar dhe lidhet kryesisht me aktivitetet e punëtorëve dhe mirëmbajtjen e zonës së punës.
Mbeturinat komunale grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm me kapak dhe ruhen përkohësisht deri në largimin e tyre nga operatori përkatës. Nuk lejohet hedhja e mbeturinave në tokë apo në sipërfaqe të papërcaktuara.
Sipas katalogut shtetëror kemi te bëjmë me mbeturina komunale siç janë:
<table>
<tr><th>Mbeturina</th><th>Emri i mbeturinës</th><th>Shkalla e rrezikshmërisë</th><th>Lloji i deponimit</th></tr>
<tr><td>20 01 39</td><td>Plastika</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina</td></tr>
<tr><td>20 01 08</td><td>Mbeturinat e ngurta komunale</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td>8.2.</td><td>Përshkrimi i Magazinimit apo deponimit te mbeturinave</td><td>Gjatë aktivitetit të Kompanisë për Eksploatim të gurit gëlqeror nuk bëhet magazinimin i përkohshëm i mbeturinave por mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim.</td></tr>
<tr><td>8.3.</td><td>Përshkrimi për trajtim, përpunimdhe riciklimi të mbeturinave</td><td>Gjatë aktivitetit të kompanisë nuk bëhet përpunim dhe riciklim i mbeturinave.</td></tr>
<tr><td>8.4.</td><td>Dërgimi për trajtim dhe riciklim te operatori tjetër – kontrate me kompaninë me leje përkatëse</td><td>Mbeturina komunale deponohen në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë privat nga kompania të cilat i dërgonë në deponit regjionale.</td></tr>
<tr><td>8.5.</td><td>Plani për menaxhimin e mbeturinave</td><td>Kompania “Toni Compani” SH.P.K. nuk ka hartuar Planin për menaxhimit me mbeturina.</td></tr>
<tr><td>8.6.</td><td>Raportimi</td><td>Nuk bënë raportimin</td></tr>
</table>

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Gjatë veprimtarisë së kompanisë "Toni Compani" SH.P.K. për eksploatimin e gurit gëlqeror, rreziqet kryesore lidhen me defektet e makinerive, mundësinë e zjarrit, aksidentet gjatë lëvizjes së mjeteve dhe aktivitetet e minimit. Në rast të ndonjë incidenti, ndërpritet menjëherë puna në zonën e rrezikut, sigurohet hapësira dhe ndërmerren masat e para të intervenimit nga personeli përgjegjës. Në rast se situata nuk mund të menaxhohet me kapacitetet e brendshme, kontaktohen shërbimet emergjente kompetente.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Kompania "Toni Compani" SH.P.K. për eksploatimin e gurit gëlqeror nuk përdor substanca të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve gjatë eksploatimit të gurit gëlqeror, kompania "Toni Compani" SH.P.K. zbaton masa të sigurisë në punë dhe kontroll të vazhdueshëm të zonës së eksploatimit. Masat kryesore përfshijnë trajnimin e punëtorëve, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, mirëmbajtjen e makinerive, kontrollin e qasjes në zonat e rrezikshme dhe zbatimin e procedurave të sigurta gjatë shpimit dhe minimit. Në rast të paraqitjes së rrezikut, puna ndërpritet menjëherë dhe ndërmerren masat përkatëse të intervenimit.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania "Toni Compani" SH.P.K. mban raport mbi gjendjen e sigurisë në zonën e eksploatimit, ku evidentohen kushtet e sigurisë në punë, gjendja e makinerive, masat mbrojtëse dhe rastet eventuale të incidenteve.
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Kompania "Toni Compani" SH.P.K. nuk e ka hartuar Planin për mbrojtjen nga zjarri.

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nuk ka ndërprerje të punës
10.2.	Ndërprerja e punës	Ndërprerja e punës bëhet vetëm gjatë sezonës së dimrit për arsye të temperaturave të ftohta.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHENDETIN E NJERIUT

Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut:

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së kompanisë "Toni Compani" SH.P.K. për eksploatimin e gurit gëlqeror në Reçak, Komuna e Shtimes, deri më tani nuk janë raportuar ndikime negative në shëndetin e njeriut apo në mjedisin përreth.

Burimet e mundshme të ndikimit gjatë operimit dhe zgjerimit të vendburimit lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën, vibrimet, qarkullimin e makinerive dhe procesin e minimit. Objektet më të afërta të banimit ndodhen rreth 1.06 km nga zona e eksploatimit, çka ndihmon në kufizimin e ekspozimit të popullatës ndaj këtyre faktorëve.

Për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve janë ndërmarrë masa si lagia e rrugëve dhe sipërfaqeve të punës, mirëmbajtja e makinerive, kontrolli i zhurmës dhe vibrimeve, si dhe zbatimi i masave të sigurisë gjatë minimit dhe transportit. Këto masa do të vazhdojnë të zbatohen edhe gjatë zgjerimit të vendburimit, së bashku me monitorimin e parametrave mjedisorë.

Personi përgjegjës për mjedis
Emri mbiemri
Fisnik Musa
Nënshkrimi

_____

Personi përgjegjës i kompanisë
Emri mbiemri
Faton Nuredini
Nënshkrimi

_____